


**MEDIA  
OWNERSHIP  
MONITOR**  
**ALBANIA**

**BYRN**  
BALKAN  
INVESTIGATIVE  
REPORTING  
NETWORK | ALBANIA

**GMR** GLOBAL  
MEDIA  
REGISTRY



# Vlerësimi i kuadrit ligjor

MONITORIMI I PRONËSISË SË MEDIAS, **SHQIPËRI**



# Përmbajtja

---

<b>Pjesa I: Përshkrimi i legjislacionit mbi përqendrimin e pronësisë së medias si dhe zbatimi, monitorimi dhe transparenca e tij</b>	<b>3</b>
<b>I.1. Kuadri ligjor</b>	<b>3</b>
<b>I.2. Zbatimi - kontrolli dhe monitorimi i përqendrimit të medias</b>	<b>11</b>
<b>I.3. Transparenca e pronësisë së medias</b>	<b>16</b>
<b>I.4. Ndikimi tjetër shtetëror mbi organizatat e medias</b>	<b>19</b>
<b>I.5. Neutraliteti i rrjetit dhe diversiteti i medias</b>	<b>21</b>
<b>Pjesa II. Treguesit - Lista e plotë</b>	<b>24</b>
<b>II.1. Masat mbrojtëse rregullatore kundër përqendrimit të lartë të pronësisë dhe /ose kontrollit (horizontal) në media</b>	<b>24</b>
<b>II.2. Kuadri Rregullator për Mediat dhe Rregullorja e Neutralitetit të Rrjetit</b>	<b>34</b>
<b>II.3. Masat mbrojtëse rregullatore kundër shkallës së lartë të ndër-pronësisë</b>	<b>36</b>
<b>II.4 Masat mbrojtëse rregullatore për transparencën e pronësisë dhe/ose kontrollit</b>	<b>39</b>
<b>II.5 Masat mbrojtëse rregullatore kundër kontrollit politik mbi pronësinë e mediave dhe rrjeteve të shpërndarjes</b>	<b>41</b>
<b>II.6 Kuadri Ligjor për Rregullimin e Medias</b>	<b>41</b>



## **Pjesa I: Përshkrimi i legjislacionit mbi përqendrimin e pronësisë së medias si dhe zbatimi, monitorimi dhe transparenca e tij.**

### **I.1. Kuadri ligjor**

- Cilat ligje supozohet se parandalojnë përqendrimin dhe monopolet në media? Në çfarë hierarkie ligjore (p.sh. kushtetutë, kod civil, ligj special apo dekret; kombëtar/rajonal) trajtohet përqendrimi i medias?

*As Kushtetuta e Shqipërisë dhe as Kodi Civil nuk përmbajnë asnjë rregullim lidhur me përqendrimin e pronësisë në media. Ligji kryesor që përmban rregulla parandaluese për përqendrimin e mediave dhe monopolizimin është Ligji nr. 97/2013, "Për median audiovizive", siç është në fuqi. Ky ligj përmban rregulla që kufizojnë përqindjen e pjesëmarrjes së një aksioneri, ose familjarëve të tij (deri në shkallë të dytë), në një kompani të dytë ose të tretë mediatike, ndërsa parashikon kufizime edhe lidhur me volumin e reklamave që mund të transmetojë një kompani mediatike. Një ligj tjetër që përmban rregulla për kufizimin e monopoleve është edhe Ligji nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Ky ligj përmban rregulla të përgjithshme për të gjithë llojet e bizneseve dhe trajton tema të kontrollit vertikal, duke përkufizuar mirë edhe rastet e kontrollit të tërthortë.*

- Cilat lloje mediaje përfshihen apo përjashtohen në rregullim? A ka ndonjë rregullim për median digjitale?

*Sipas ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive", në fushëveprimin e tij hyjnë vetëm ato media audiovizive që transmetojnë në frekuenca analoge apo digjitale, përfshirë mediat audio dhe kablllore, si dhe transmetimet satelitore. Nuk ka ligj/rregullore ekuivalente për median e shkruar apo portalet online.*

- Nëse nuk ka – ose ka jo mjaftueshëm - legjislacion: a ka një legjislacion në përgatitje? Cili është status quo-ja i procesit politik?

*Aktualisht, nuk ka asnjë zhvillim politik apo legjislativ në pritje apo në shqyrtim për futjen e rregulloreve të mëtejshme mbi pronësinë e medias, parandalimin e monopolizimit dhe përqendrimin e pronësisë së medias.*

*Mbetet i paqartë statusi i "Paketës Antishpifje", një grup me dy projektligje, e nisur nga fundi i vitit 2019, një herë e miratuar nga Kuvendi dhe më pas iu vendos vetoja nga Presidenti i Republikës, duke e kthyer përsëri në Parlament për shqyrtim, ku përfundimisht u rrëzua, por asnjëherë zyrtarisht. "Paketa" vendos kufizime dhe sanksione për mediat online dhe është kritikuar shumë nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, etj.*

*Këto dy projektligje të "paketës" fillimisht u rishikuan dhe janë ende një rudiment në axhendën e komisioneve kompetente parlamentare. Në vitin 2022 u konfirmua nga deputetët e opozitës*

*se drafti është ende në rend dite, por pas gati dy vitesh të plota mosveprimi, duket se kjo nismë është braktisur përfundimisht. Ndonëse nuk ka pasur asnjëherë një konfirmim zyrtar për këtë çështje, në tetor 2022, kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste njoftoi se deputetët që iniciuan draftin, e tërhoqën atë.*

- Ju lutem, përshkruani se si ligji përkufizon përqendrimin e medias (p.sh, pronësia ndërsektoriale; pjesa e audiencës, qarkullimi, xhiroja/të ardhurat, kapitali aksionet apo të drejtat e votës). A janë anëtarët e familjes të përfshirë në rregullat e konfliktit të interesit? Si konsiderohet lidhja e tyre në përkufizimin e pronësisë?

*Ligji për mediat audiovizive nuk parashikon përkufizime për sa i takon monopolizimit dhe përqendrimin të medias në mënyrë të veçantë. Të vetmet koncepte që ligji prezanton janë kufizimi për pjesëmarrje të aksioneve/të drejtës së votës së pronarit në një shoqëri të dytë dhe kufizimi për të mos përfituar mbi një vlerë të caktuar në tregun e reklamave, për mediat audio dhe audiovizive.*

*Për median audiovizive, përcaktohen kufizime të lidhura me përqindjen e kapitalit të përgjithshëm (20%) në një shoqëri të dytë që zotëron licencë kombëtare, ndërsa për transmetimet analoge audio, kapitali i lejuar është deri në 10% për pjesëmarrjen në një shoqëri të tretë kombëtare.*

*Kuadri ligjor në fuqi gjithashtu kufizon më tej përqindjen e aksioneve që një aksioner mund të ketë në lidhje me një kompani të dytë mediatike që zotëron një licencë kombëtare ose rajonale.*

*Ligji për median audiovizive parashikon edhe kufizimin tjetër me karakter tregtar, që ka të bëjë me moslejimin e zotërimit të më shumë se 30% të tregut të reklamave nga një shoqëri me licencë kombëtare të transmetimit audio ose audioviziv.*

*Ligji për mediat audiovizive rregullon edhe situatat e konfliktit të interesit që lindin në rastet kur dy ose më shumë aksionerë të një shoqërie mediatike janë anëtarë të familjes deri në shkallën e dytë. Në raste të tilla, ligji do të lejojë vetëm një nga aksionerët të mbajë aksione në atë shoqëri.*

- A merr parasysh legjislacioni integrimin vertikal (d.m.th. kontrollin nga një person i vetëm, kompani apo grup i disa elementëve kyç të zinxhirit të vlerës, p.sh., prodhimin, agregimin, shpërndarjen dhe industrinë e lidhura të tilla si reklammat apo telekomunikacioni)? Si?

*Legjislacioni i posaçëm për median e shkruar dhe audiovizive nuk ka parashikime ligjore për sa i takon kontrollin vertikal të medias.*

*Ligji 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" në fuqi, parashikon kufizime vetëm në lidhje*



me përqendrimin e sipërmarrjeve aktive në të njëjtën fushë të veprimtarisë ekonomike. Megjithatë, ky kufizim nuk është specifik për kompanitë e medias, por zbatohet për të gjitha shoqëritë e përfshira në çdo formë aktiviteti ekonomik (shiko Nenin 10 të ligjit nr. 9121/2003). Sipas këtij ligji, ndalohej përqendrimi i ndërmarrjeve kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:

a) shkrirjes së dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra;

b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm;

c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjesë të këtyre të fundit.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon kufizime lidhur me kontrollin vertikal kur ndërmarrjet mediatike në fjalë janë të ndara dhe aktive në fusha të ndryshme (ndonëse të lidhura) të prodhimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

- A ka pasur ndryshime në legjislacion mbi problemet e përqendrimit të medias përgjatë pesë viteve të fundit? A ka pasur ndonjë hyrje madhore të re në treg apo bashkime & blerje (M&S)? Si janë trajtuar këto raste? A ka pasur konflikte të rëndësishme?

Ka pasur zhvillime gjatë pesë viteve të fundit që kanë prekur rregullimin e medias dhe tema të ndjeshme mbi lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit në Shqipëri.

### 1. Paketa "Antishpifje"

"Paketa Antishpifje", një grup prej dy projektligjesh, filloi nga fundi i vitit 2019, u miratua nga Kuvendi dhe më pas iu vu vetoja nga Presidenti i Republikës, duke e kthyer sërish në Parlament për shqyrtim, përfundimisht u rrëzua. Kjo "paketë", që vendos kufizime dhe sanksione për mediat online, është kritikuar shumë nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, Ambasada e SHBA-së në Tiranë dhe së fundmi nga OSBE-ja. Shumë gazetarë dhe grupe të shoqërisë civile protestuan kundër zgjerimit drastik të rolit të Autoritetit të Medias Audiovizive të Shqipërisë (AMA), duke krijuar një organ administrativ me kompetencën për të gjositur dhe mbyllur media online dhe të huaja - të gjitha pa një urdhër gjykatë.

Pasi drafti u kthye për shqyrtim, Parlamenti vendosi t'i kërkonte Komisionit të Venecias një ekspertizë për këtë çështje. Ky i fundit pati një vizitë studimore dhe u takua me shumë aktorë,

nga gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese e deri tek aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë. Opinioni zyrtar i Komisionit të Venecias ishte se drafti paraqiste disa probleme në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes, duke pasqyruar të gjitha argumentet e paraqitura nga shoqëria civile dhe organizatat e medias.

Në tetor 2022, kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste njoftoi se deputetët që iniciuan projektligjin, e tërhoqën atë.

## 2. Agjencia për Media dhe Informim

Një tjetër zhvillim i fundit që ndodhi në shtator 2021 ka ngritur shqetësime mes gazetarëve. Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 512, datë 18.09.2021, ka miratuar krijimin e Agjencisë Shtetërore për Media dhe Informim, e cila do të monopolizonte komunikimin publik të qeverisë dhe organeve në varësi të saj. Funksionimi i kësaj agjencie rrezikon të ndërhyjë në të drejtën për informim që rregullohet nga ligji i posaçëm për të drejtën e informimit. Komuniteti i gazetarëve ka reaguar ashpër ndaj këtij hapi të qeverisë. Gjatë vitit 2022, kjo agjenci u themelua plotësisht dhe u monitorua nga OSHC-të, duke zbuluar se vërtet ka shenja ndërhyrjeje, edhe pse me një shkallë më të ulët se sa pritej.

## 3. Ndryshim në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Një ndryshim i fundit i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” është miratuar me ligjin nr. 30/2023. Ky ndryshim synonte të përafrohej me direktivën (BE) 2018/1808, e cila ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 10 mars 2010, “Për bashkërendimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimit audio dhe video” (Direktiva për shërbimin mediatik audio dhe video).

Ky ndryshim synon rishikimin e rregullave për transmetuesit audioviziv si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, duke përfshirë rregulla për sigurimin e aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, forcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive sipas kërkesës (shërbimi sipas kërkesës). Ai merret me koncepte të reja si bashkërrëgullimi, vetë-rëgullimi, edukimi mediatik, ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove, shërbimi i platformës së shpërndarjes së videove, si dhe “video e gjeneruar nga përdoruesit”.

Ndryshimi rishikoi rregullat e bartjes së detyrimit, në përputhje me direktivën 2018/1972 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 11 dhjetor 2018, për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimit Elektronik.

Konkretisht, lidhur me transparencën e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, në



*Nenin 32 është futur një dispozitë e re. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:*

*“1/1. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive bëjnë publike informacionin për strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.”*

*Një ligj i veçantë, nr.. 112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2022, vendos rregulla më të detajuara për regjistrimin dhe publikimin e pronarëve përfitues.*

#### *4. Draft-amendament për ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

*Një tjetër zhvillim i rëndësishëm i kohëve të fundit është ndryshimi i ligjit për të drejtën e informimit, i paraqitur fillimisht nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Drafti prezantoi disa koncepte të reja që u shoqëruan me reagime të ndryshme. Nga njëra anë, u evidentuan disa ndryshime të mira, si shtimi i mekanizmave të zbatimit të vendimeve të Komisionerit, apo kalimi i përgjegjësisë nga koordinatorët për të drejtën e informimit te krerët e autoriteteve publike në rast shkeljesh. Nga ana tjetër, drafti paraqiste disa ndryshime mjaft të diskutueshme, si refuzimet për qasje në informacion në rast të një kërkesë “abuzive”, duke i lënë shumë hapësirë autoriteteve për ta përdorur me tepri dhe keqpërdorur këtë të drejtë. Një tjetër ndryshim problematik i propozuar ishte heqja e veprimtarisë së gjykatave dhe prokurorive nga objekti i ligjit. U identifikuan gjithashtu shumë probleme të tjera dytësore. Pas një raundi të gjatë konsultimesh, drafti është rishikuar dhe shumë çështje të trajtuara fillimisht nuk janë pjesë e draftit të fundit të publikuar për konsultim të mëtejshëm.*

#### *5. Hyrje dhe blerjet e reja*

*Kastrati Group është bërë zyrtarisht pjesë e Intermedia Group me 60% të aksioneve, ndërsa 40% e aksioneve i mbeten z. Th. Ç.. Intermedia Group është një kompani mediatike që përfshin gjithashtu Euronews Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.*

*Devolli Group është raportuar se ka blerë televizionin ABC me seli në Tiranë.*

*Në tregun mediatik ka hyrë edhe Grupi Balfin. Grupi ka njoftuar Autoritetin e Konkurrencës për transaksionin e marrjes së kontrollit të shoqërisë SCAN sh.a., me veprimtari radiotelevizive, me fokus ekonominë.*

*Një tjetër biznesmen i njohur, I.H. do të hapë një kanal të dytë televiziv. Pas News 24, pritet të dalë në tregun mediatik edhe me një kanal i dytë, i quajtur Panorama TV. Në fund të tetorit 2021, ai bleu televizionin UTV Education.*

*Pas më shumë se dy vitesh gjyqe për të mbyllur dhe konfiskuar RTV Ora, të zhvilluara në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, oficerët e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe administratorët shtetërorë morën nën kontroll*

RTV Ora më 4 nëntor 2022.

## 6. Disa informacione të tjera

Me partinë kryesore opozitare (Partia Demokratike) në gjendjen e saj më të dobët për shkak të konfliktit të ashpër të brendshëm të hapur dhe të vazhdueshëm të shkaktuar nga vendimi i Departamentit Amerikan të Shtetit për të caktuar si “non grata” ish-kryetarin e saj historik, opozita është në pikën e saj më të dobët për të mbajtur përgjegjëse qeverinë. Shumë OSHC dhe media konsiderojnë se ky rol duhet të mbahet i ndarë midis shoqërisë civile dhe veçanërisht të medias. Megjithatë, për fat të keq, përpjekjet e tyre pengohen, ndër të tjera, nga kërcënimet dhe shkeljet e shpeshta të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për informim.

Në një pikë tjetër pozitive, gjykatat vazhdojnë të zhvillojnë një linjë të mirë jurisprudence. Megjithëse jurisprudenca është bërë më mbrojtëse e të drejtave të gazetarëve, gjykatat vendase duket se ende nuk janë të vetëdijshme sa duhet për të gjitha parimet ndërkombëtare dhe udhëzimet e përcaktuara mirë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Një shembull domethënës është rasti i Lapsi.al (një media online), për të cilin u lëshua një urdhër sekuestrimi për kompjuterë, telefona inteligjentë dhe pajisje të tjera elektronike, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi një masë të përkohshme sigurie (e përdorur shumë rrallë për çështje që lidhen me Nenin 10 të GJEDNJ). Gjykata Evropiane e pranoi kërkesën dhe urdhëroi menjëherë autoritetet gjyqësore shqiptare që të mos procedojnë me ekzekutimin e vendimit të gjykatës vendase.

- A është përqendrimi i medias aktualisht në axhendën e ligjvënësve apo politikëbërësve? Cilat janë pikat e errëta në legjislacionin mbi përqendrimin e medias?

Përqendrimi i medias nuk konsiderohet një shqetësim urgjent për momentin. Si rezultat, nuk ka politika apo nisma legjislative që synojnë adresimin e tij.

E vetmja herë kur kjo çështje u soll në vëmendjen e politikëbërësve ishte në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të datës 13.04.2017, me të cilën Kuvendi i Shqipërisë miratoi raportin e aktivitetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2016. Në këtë rezolutë, Kuvendi i Shqipërisë i bëri thirrje AMA-s që të zbatojë masat për nxitjen e respektimit të ligjit për mediat audiovizive, si dhe shqyrtimin dhe adresimin e çështjeve të pronësisë së transmetuesve dhe reklamave. Megjithatë, raporti nuk përmbante referenca për shqetësimet apo problemet në lidhje me këto apo çështje të tjera.

Gjithashtu çështje të kontrollit vertikal, të cilat rregullohen nga Ligji 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duhet gjithashtu të jenë pjesë e legjislacionit të posaçëm për median, të paktën atë audiovizive, si mediat më me impakt. Për zbatimin e këtij ligji është ngritur dhe funksionon Autoriteti i Medias Audiovizive, të cilit mund t’i ngarkohet posaçërisht kontrolli

*mbi këtë fushë. Miratimi një zgjidhjeje të tillë do të shmangte edhe rrezikun e një konflikti kompetencash midis AMA-s dhe Autoritetit të Konkurrencës, organ ky që mbikëqyr zbatimin e Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës së fundmi argumentoi se nuk është ky organi kompetent për një ankesë lidhur me një media audiovizive, pasi fushën e medias e mbulon vetëm AMA, e krijuar posaçërisht për të garantuar mirëfunksionimin e medias në vend. (shih Vendimin nr. 471, dt. 25.07.2017).*

*Legjislacioni nuk përmban mekanizma të qartë që synojnë parandalimin e kontrollit vertikal, edhe në lidhje me persona/subjekte që, megjithëse janë aktivë në fusha jo mediatike, marrin pjesë edhe në zinxhirin e prodhimit dhe transmetimit audioviziv. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka mekanizma ligjorë që synojnë parandalimin e kontrollit horizontal.*

*Ligji nuk parashikon qartë kufizimin për zotërimin e 30% të reklamave, pasi nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për vlerën e reklamave apo për kohën e transmetimit. Gjithashtu nuk bëhet e qartë se si matet volumi i teleshitjeve, duke bërë të pamundur qëllimin primar të tij që ka qenë kufizimi i zotërimit të tregut.*

*Për më tepër, pavarësisht nga ekzistenca e një lex specialis në formën e ligjit “Për mediat audiovizive”, ky i fundit nuk përmban dispozita që rregullojnë rastet e përqendrimit të tërthortë të pronësisë së medias.*

*Legjislacioni nuk ka përkufizime të koncepteve të tjerë që lidhen me përqendrimin e medias të tilla si shikueshmëria; xhiroja; niveli i përgjithshëm i të ardhurave nga burime të tjera përveç reklamave si sponsorizime, projekte, grante, etj. Të ardhurat nga sponsorizimet nuk përfshihen te kriteret ndaluese njësoj si kufizimet e parashikuara në rastin e reklamave. Kjo sjell mundësinë e deklaramit të reklamave si sponsorizime duke e vështirësuar monitorimin e tregut të reklamave. Gjithashtu nuk ekziston asnjë kufizim për mospjesëmarrjen e të njëjtit person fizik ose juridik në pronësinë e mediave të tjera që nuk janë audiovizive.*

- A ka legjislacion specifik mbi investimin/pronësinë e huaj brenda biznesit të medias?

*Legjislacioni shqiptar nuk diskriminon personat e huaj. Ata lejohen të investojnë/kenë në pronësi nën të njëjtat kushte si edhe shtetasit shqiptarë. I vetmi kufizim është i natyrës tregtare, ku investitorit të huaj i kërkohet të regjistrojë një shoqëri aksionere në Shqipëri.*

## **1.2. Zbatimi - kontrolli dhe monitorimi i përqendrimit të medias**

- A ka një sistem institucional për të trajtuar përqendrimin e medias? Cilët sektorë - p.sh. shtypi, transmetimi apo media e re - janë përfshirë? Cilat janë organet përgjegjëse që qeverisin përqendrimin e medias? Cilat janë detyrat, punët dhe

përgjegjësitë e autoritetit/eve të përkufizuara në detaje në ligj (p.sh. dhënie licencash, monitorim të zbatimit, sanksionim e të tjera)?

*Ligji nr. 97/2013, në nenin 62 parashikon disa mekanizma për të shmangur përqendrimin e medias. Këtij kufizimi i nënshtrohen vetëm mediat audiovizive. Shtypi dhe mediat online nuk i nënshtrohen ndonjë kufizimi. Në fushën e transmetimeve audiovizive, organi përgjegjës është Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) që mbikëqyr zbatimin e mekanizmave që garantojnë përqendrimin e medias. Disa prej funksioneve kryesore të AMA-s janë: dhënia dhe heqja e licencave dhe/ose autorizimeve; garantimi i konkurrencës së ndershme; bashkëpunimi me institucione të tjera për përmbushjen e objektivave ligjorë, si Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit; monitorimi i programeve të transmetuara nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv. AMA kontrollon gjithashtu zbatimin e ligjit për mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive dhe në rast shkeljesh, merr masa administrative dhe vendos sanksione.*

- Nëse ka më shumë se një autoritet përgjegjës (p.sh. autoritet të medias, autoritet konkurrence, etj.): si bëhet diferencimi i kompetencave të autoriteteve të ndryshme? A funksionon ligji apo a ka mbivendosje apo hapësira të papërcaktuara?

*Në Shqipëri ka vetëm një autoritet që kryen funksione monitorimi dhe kontrolli në lidhje me median audiovizive që është AMA. Duhet përmendur edhe Autoriteti i Konkurrencës, i ngritur në bazë të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i cili operon në fushën e konkurrencës.. Ky ligj garanton kënaqshëm shmangien e përqendrimin të ndërmarrjeve dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg, por nuk trajton në mënyrë specifike tregun mediatik që ka veçoritë e veta unike. Kështu për shembull, nuk ka asnjë term/koncept të ligjit tregtar të barasvlershëm me atë të audiencës, një lëshim i rëndësishëm nga ana e ligjvënësit pasi audiencia (d.m.th. publiku) është konsumatori i drejtpërdrejtë i produkteve që thjesht reklamohen (dhe nuk prodhohen) nga mediat. Teorikisht një media mund të ketë një shikueshmëri të madhe pavarësisht se mund të zotërojë një pjesë më të vogël të tregut të reklamave. Dominimi i audiencës është kështu një faktor që, megjithëse nuk reflekton domosdoshmërisht konkurrencën në fushën e reklamave mediatike, mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm në fushën politike duke formësuar opinionin publik.*

- A ka garanci ligjore mbi pavarësinë eksplicite dhe kushtetuese të autoriteteve (media, konkurrence, telekomunikacion...) nga ndërhyrjet politike apo/ose komerciale?

*Autoriteti i Mediave Audiovizive është organ i pavarur i themeluar sipas ligjit nr. 97/2013. Ligji parashikon një mekanizëm kompleks i cili garanton pavarësinë e anëtarëve të këtij*

*organi si nga ndërhyrjet politike edhe ato të natyrës tregtare. Organe të tjerë, si Autoriteti i Konkurrencës ose Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, janë organe të pavarura, anëtarët e të cilëve emërohen nga Kuvendi. Megjithatë, Megjithatë, anëtarët e këtyre organeve nuk përfitojnë një sërë garancish të ngjashme kundër ndërhyrjeve politike, pasi për emërimin e tyre kërkohet vetëm një shumicë e thjeshtë parlamentare. Kjo nga ana tjetër sugjeron se çdo qeveri në detyrë pothuajse gjithmonë do të jetë në gjendje të emërojë kandidatët që ajo favorizon.*

- *Si janë procedurat e emërimit për autoritetet (p.sh. transparente, demokratike dhe objektive dhe të dizenuara për të minimizuar rrezikun nga ndërhyrjet politike apo komerciale, për shembull, duke përfshirë rregullat e papërputhshmërisë apo zgjedhshmërisë)? A respektohen ato në praktikë?*

*Rregullat dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të autoriteteve janë transparente, demokratike dhe objektive. Rregullat janë përfshirë në legjislacion me përkujdesjen e OSBE.*

*Në praktikë, këto rregulla nuk janë respektuar gjatë emërimit të anëtarëve të AMA-s. Kështu, procedura e parashikuar për emërimin e anëtarëve të AMA-s është përcaktuar në ligjin nr. 97/2013. Sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj, shoqëria civile propozon kandidatët për AMA-n. Më pas, partisë në pushtet dhe opozitës i jepet mundësia të kërkojnë skualifikimin e çdo kandidati për të cilin kanë rezerva, qëllimi i këtij ushtrimi është që gradualisht të dilet me një listë kandidatësh që nuk kontestohen (në vend që të preferohen/zgjidhen) qoftë nga maxhoranca e qoftë nga opozita.*

*Gjithsesi, kjo procedurë nuk u respektua nga Kuvendi në emërimin e anëtarëve të rinj të AMA-s, ku Kuvendi thjesht emëroi kandidatët e propozuar nga maxhoranca dhe opozita.*

*Bashkimi Evropian kërkoi shtyrjen e procesit të emërimit të kreut të AMA-s për në shtator 2021, ndërsa procedura për emërimin u krye gjatë qershorit 2021, ku morën pjesë pak kandidatura. Për më tepër, përfaqësuesit e opozitës në Kuvend ishin deputetët zëvendësues të opozitës, ata që refuzuan të dorëzonin mandatin radhazi pas vendimit të partive kryesore opozitare për bojkotim të Kuvendit. Kjo situatë e thelloi problemin duke emëruar anëtarë të AMA-s vetëm me vullnetin e shumicës parlamentare dhe pa kontroll efektiv të opozitës. OSBE-ja bëri thirrje që procesi të ishte transparent. Megjithatë, Kuvendi ka publikuar vetëm disa pjesë të mbledhjes së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke lënë të pa publikuar procedurën e përjashtimit të kandidatëve të AMA-s. Në përgjithësi, procesi ishte larg të qenit korrekt dhe pati reagime nga partitë opozitare, por edhe nga organizatat ndërkombëtare, si "Safe Journalists", të cilat shprehën shqetësimin për pavarësinë dhe profesionalizmin e kandidatëve për kreun e AMA-s.*

*Krahas ndikimit politik, emërimi i disa prej anëtarëve të AMA-s ngriti shqetësime edhe për ndikime të mundshme politike, si zgjedhja si kryetare e AMA-s e një ish-zëdhënëse të kryeministrit aktual dhe aktive në zyrën e shtypit të kryeministrit aktual.*



- A është buxheti i përshtatshëm dhe në përputhje që autoriteti të ruajë pavarësinë dhe/ose ta mbrojë atë nga presionet shtrënguese buxhetore për të kryer funksionet e veta?

*Sipas ligjit 97/2013, buxheti i AMA-s përbëhet nga të financime nga burime të ndryshme si edhe nga financimi nga buxheti i shtetit. Kryesisht të ardhurat janë nga tarifatat që operatorët paguajnë dhe një formë e tillë financimi kontribuon në pavarësinë e AMA-s.*

*Megjithatë, nuk mund të vlerësohet se sa janë nevojat reale të AMA-s dhe nëse buxheti aktual është adekuat ose jo.*

- Çfarë fuqish sanksionuese kanë autoritetet për të plotësuar rolin e tyre (p.sh. fuqi për të refuzuar kërkesat dhe për të disinvestuar në operacionet ekzistuese të medias kur pluralizmi kërcënohet apo kur ka përqendrim në nivel të papranueshëm pronësie? A ka mekanizma efikase apeli?

*Neni 132 i ligjit 97/2013 parashikon sanksione të ndryshme në rastet e shkeljes së dispozitave të tij. Kështu AMA mund të vendosë:*

- a) gjobë;*
- b) pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;*
- c) reduktim të kohës së licencës dhe/ose autorizimit;*
- ç) heqje të licencës dhe/ose autorizimit.*

*Ligji nuk parashikon mekanizma për të shmangur situata që rrezikojnë pluralizmin e medias ose përqendrimin e pronësisë në nivele të papranueshme.*

*Ligji parashikon mekanizma ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër sanksioneve të vendosura nga AMA. Mjetet e ankimit janë efektive në kuptimin e aksesit në organet quasi gjyqësore (AMA) dhe gjyqësore.*

- Ju lutem, përshkruani metodën dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të përqendrimit të medias (p.sh. limite bazuar të kriteret objektive, të tilla si pjesa e audiencës, qarkullimi, xhiro/të ardhurat, shpërndarja e kapitalit aksioner apo të drejtave të votës; duke marrë parasysh njëkohësisht integrimin horizontal (bashkimet brenda të njëjtës degë të aktivitetit) dhe integrimin vertikal (kontrollin nga një person i vetëm, kompani apo grup elementësh kyç të proceseve të prodhimit dhe shpërndarjes, dhe aktivitetet e lidhura të tilla si reklamata).

*Ligji nuk parashikon kriteret për vlerësimin e nivelit të përqendrimit të pronësisë mbi mediat bazuar në shikueshmërinë ose nivelin e fitimeve. Ligji parashikon kriteret për xhiron (këto kriteret mund të gjenden në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës) dhe shitjen e reklamave në*



*veçanti (në Ligjin për Mediat Audiovizive). Mungojnë parashikimet për integrimin horizontal, ndërsa integrimi vertikal gjen rregullim të pjesshëm.*

*Mungon një parashikim për të ardhurat nga sponsorizimet dhe projektet/grantet, të ardhura që nuk konsiderohen shitje nga reklamata.*

- A është autoriteti llogaridhënës për publikun për aktivitetet e tij (p.sh. është i detyruar të publikojë raporte të rregullta apo sipas rastit në lidhje me punën e tyre apo me ushtrimin e misionëve të tyre)?

*Të gjitha autoritetet e parashikuara nga ligji kanë detyrimin të raportojnë aktivitetet e tyre. Raportet prezantohen periodikisht në Kuvend dhe bëhen publikë, së bashku me rezolutat e Kuvendit. Ndërkohë raportet ad hoc nuk janë të detyrueshëm, por nëse raporte të tilla por legjislacioni për të drejtën e informimit detyron publikimin e tyre në faqen e internetit të autoritetit.*

*AMA, përveç raportit vjetor, mund të paraqesë raporte në lidhje me aspekte të ndryshme të punës së saj, në bazë të kërkesës së Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.*

- A mundet që qeveria në mënyrë arbitrare të përmbysë vendimet e autoritetit? Në cilat raste? A ka raste të ndërhyrjes së paligjshme shtetërore?

*Qeveria nuk mund të shfuqizojë apo ndryshojë vendimet e autoritetit, pasi sipas legjislacionit në fuqi autoriteti është plotësisht i pavarur. Në bazë të të gjitha të dhënave të disponueshme publikisht, nuk mund të arrihet në përfundimin se ka pasur ndërhyrje të paligjshme nga qeveria në proceset vendimmarrëse të autoritetit.*

- A ka pasur raste shkrirjesh dhe blerjesh përgjatë pesë viteve të fundit? Sa proaktive dhe sa në mënyrë të detajuar i ka zbatuar rregulloret autoriteti mbi pronësinë e medias? A ka pasur raste kur rregullatorët kanë refuzuar kërkesën për licencë, shkrirje apo kanë detyruar disinvestime në operacionet ekzistuese të medias në mënyrë që të shmangin përqendrimin e tepërt të pronësisë së medias? Cilat janë sfidat kryesore të autoritetit për zbatimin?

*Në pesë vitet e fundit nuk janë shënuar raste të shkrirjes së mediave. Përsa i përket blerjeve, është shënuar një rast ku pronari i një media audiovizive kombëtare ka blerë aksione në një media tjetër me licencë lokale.*

*AMA ka publikuar vendimet e arsyetuara deri në vitin 2020, ndërsa për vitet e mëvonshme ka të dhëna për vendimmarrjen. Ka raste të refuzimit të dhënies së licencave, si dhe raste të pavlefshmërisë së licencave. Por këto vendime janë të pakta dhe nuk lidhen me refuzime për të shmangur përqendrimin e tepruar të pronësisë së medias.*

*Me këtë nivel të kufizuar në arsyetimin e vendimeve, nuk është e mundur të arrihet në përfundime lidhur me sfidat që autoriteti është përballur për zbatimin e ligjit.*

- A tregon praktika vendimmarrëse e autoriteteve se ata përdorin fuqitë e tyre në praktikë në interes të publikut? A ka pasur raste abuzimi me fuqinë rregullatore? Çfarë, kur? A konsiderohen autoritetet organe politike apo teknike?

*Nuk ka pasur raste që janë ngritur shqetësime nëse praktikat vendimmarrëse të autoritetit ishin në kundërshtim me interesin publik.*

*Nga ana tjetër, ka pasur shqetësime për vendimin për emërimin e ish-zëdhënëses së kryeministrit aktual në krye të AMA-s dhe vendimin për emërimin e një personi të lidhur hapur me opozitën si z/kryetar të AMA-s. Ky i fundit deklaroi në rrjetet sociale se “Për sa u përket vendeve në bordin e AMA-s, ato janë karrige të opozitës dhe i përkasin asaj”. Kjo situatë e shndërron AMA-n në një bord dypartiak dhe jo të pavarur, siç e parashikon ligji.*

### **I.3. Transparenca e pronësisë së medias**

- Ju lutem, përshkruani praktikat e publikimit të transparencës të detyrueshme (ligjërishit) ose të padetyrueshme (vullnetarisht) të kompanive të medias në lidhje me pronësinë, investimin dhe burimet e të ardhurave?

*E vetmja rregullore e veçantë për transparencën mediatike është regjistrimi i publikimit të pronarëve përfitues, siç parashikohet nga rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues, sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Regjistri i Pronarëve Përfitues drejtohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Duke qenë se të gjitha kompanitë mediatike (ashtu si çdo biznes tjetër në vend) duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të specifikojnë emrat e aksionerëve të tyre, të dhënat e pronësisë janë të disponueshme në internet për shumicën e mediave, përfshirë median e shkruar.*

*Gjithashtu, AMA ka kompetencë të inspektojë raportet financiare të subjekteve që licencën dhe vendimmarrjet lidhur me këtë proces janë të aksesueshme online.*

*Të dhënat e pronësisë për mediat online janë shumë më të vështira të sigurohen, meqenëse nuk iu kërkohet të regjistrohen as si biznes dhe as si organ mediatik. Megjithatë, shumica e*

*mediave online që e drejtojnë aktivitetin si biznes (shesin reklama) janë tashmë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.*

*Nga ana tjetër, mediave elektronike që përdorin transmetime audiovizive iu duhet të regjistrohen si pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, ashtu edhe pranë rregullatorit, Autoriteti për Mediat Audiovizive. Autoriteti rregullator nuk ka një regjistër online që të përmbajë të dhënat e pronësisë për organet mediatike, por këto mund të vihen në dispozicion me kërkesa zyrtare për të drejtë informimi.*

- Cilat organizata të medias mbulohen nga kërkesat për raportim? Kujt duhet t'i raportojnë ato? Sa shpesh/në cilat raste të dhënat duhet të përditësohen?

*Si çdo biznes tjetër, të gjitha organet mediatike duhet t'ia paraqesin raportet financiare vjetore zyrës së tatimeve, por këto raporte janë konfidenciale.*

*Pasqyrat financiare të biznesit të medias dorëzohen edhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe këtu ato gjenden online në regjistrin publik.*

*Edhe mediat elektronike me transmetime audiovizuale duhet t'ia paraqesin raportet financiare autoritetit rregullator.*

*Pasqyrat financiare dorëzohen çdo një vit pranë organeve tatimore dhe QKB-së.*

*Me nismën e saj, AMA mund të kërkojë informacion financiar dhe ekonomik nga kompanitë e mediave audio dhe audiovizive; ushtrimi i kësaj kompetence bie tërësisht në diskrecionin e saj.*

*Situata është ndryshe në rastin e disa mediave online, të cilat nuk operohen nga subjekte të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Në këtë mënyrë, këto subjekte nuk detyrohen të bëjnë transparencë pranë autoriteteve vendase.*

- Çfarë informacioni kërkohet që të publikohet? (p.sh. organet/personat kyç dhe funksionet e tyre në media; detajet e aksionerëve dhe përmasat e pronësisë së tyre, pronarët finalë; interesat e njerëzve/organeve në media të tjera/sectorë ekonomikë; njerëz me ndikim në programim/politikë editoriale; lidhjet politike apo të tjera të pronarëve dhe anëtarëve të familjes së tyre; të ardhurat nga reklamat publike, financimet nga burime të tjera të jashtme)

*Në rastin e paraqitjes së kërkesës për autorizim nga AMA, aplikuesi duhet të dorëzojë informacion të detajuar, si emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit, të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar, të dhëna për programet, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, listën e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve, listën emërore të*

*anëtarëve të bordit drejtues dhe jetëshkrimin e tyre, informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionerëve të saj. Aplikuesi duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.*

*Kompanitë mediatike janë të detyruara të dorëzojnë bilancet financiare vjetore në organet tatimore dhe QKB një herë në vit.*

*Detaje mbi emrat e aksionerëve dhe numrit të aksioneve të tyre janë të dhëna që publikohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për mediat, por vetëm kur këto të fundit janë të regjistruara si biznese.*

*Radio Televizioni Publik Shqiptar duhet gjithashtu të dorëzojë çdo vit bilance financiare te AMA dhe në Kuvend.*

*Përpara se të bëhet ndonjë përqendrim i sipërmarrjes, ligji kërkon miratimin paraprak nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili është kompetent në këtë fushë për të gjitha kategoritë e bizneseve. Ky detyrim lind në rastet kur xhiroja parashikohet të kapërcejë një prag të caktuar. Ky detyrim lindi në rastin e kompanisë "Media Vision", e cila edhe pse kishte detyrimin të njoftonte Autoritetin e Konkurrencës për përqendrimin që kishte arritur, nuk e bëri këtë brenda afatit përkatës.*

*Media nuk e ka për detyrim të raportojë mbi njerëzit që influencojnë programet dhe linjën editoriale, preferencën politike të pronarëve, burimet e tjera të financimit dhe, më e rëndësishme nga të gjitha, lidhjen e pronarëve të medias me biznese të tjera në sektorë të tjerë ekonomikë.*

- Sa i aksesueshëm është informacioni për publikun? Në çfarë mënyre informacione bëhet i disponueshëm? A është ai i kuptueshëm për publikun e gjerë?

*Informacioni që lidhet me përqindjen e aksioneve dhe të dhëna të aksionerëve dhe bilancet vjetore gjenden online në regjistrin elektronik të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Bilancet vjetore janë të aksesueshme duke klikuar linkun e përfshirë në "ekstraktin historik" që mund të shkarkohet nga çdo anëtar i publikut. "Ekstrakti historik" përmban informacione të detajuara në lidhje me emrat dhe aksionet e aksionerëve dhe ndryshime historike.*

*Informacioni lidhur me funksionet e personave që punojnë në sektorin e medias, si pagat ose pozicioni i tyre në një media të caktuar, gjenden pranë organeve tatimore, por këto konsiderohen të dhëna konfidenciale dhe nuk janë të aksesueshme.*

*Gjithashtu, AMA ka informacione për mediat elektronike; një informacion i tillë është në parim i disponueshëm nëpërmjet kërkesave për të drejtë informimi. Sidoqoftë, duhet të theksohet se jo të gjitha informacionet mund të jenë të aksesueshme pasi mund të bien nën sekretin tregtar ose përjashtime nga të dhënat personale.*

*Informacionet për aksionerët janë të thjeshta për t'u kuptuar, ndërsa informacionet për pasqyrat financiare janë të aksesueshme dhe të kuptueshme vetëm nga ekspertë të fushës.*

- Si monitorohet dhe rregullohet kjo? A ka sanksione për dështimin në raportim?

*Nuk ka rregullime ligjore të posaçme për fushën e medias, por legjislacioni fiskal është i detyrueshëm për të gjitha bizneset, përfshirë mediat. Legjislacioni për median audiovizive parashikon detyrimin për raportim të mediave online, ndërsa është legjislacioni tatimor ai që rregullon detyrimin e medias për të dorëzuar bilancet vjetore. Mosdorëzimi i tyre brenda afateve kohore shoqërohet me gjobë në masën 60.000 ALL, ose 600 Euro.*

- Kushtet për transparencë: A e monitoron organi përgjegjës respektimin e kushteve? A i plotëson media kërkesat ligjore?

*Nuk ka dispozita të veçanta ligjore në lidhje me transparencën mediatike të zbatueshme për kompanitë mediatike; monitorimi i tyre kryhet, si për çdo biznes tjetër, kryesisht nga organet tatimore.*

#### **I.4. Ndikimi tjetër shtetëror mbi organizatat e medias**

- A imponon shteti taksa të papërbalueshme mbi organizatat e medias? A është politika dhe praktika fiskale e qeverisë diskriminuese apo në favor të mediave specifike private në krahasim me të tjera?

*Nuk identifikohen taksa të posaçme për mediat. Politikat tatimore nuk paraqiten diskriminuese, por praktikatat e autoriteteve tatimore mund të shfaqen diskriminuese në lidhje me shpeshësinë e kontrolleve dhe ashpërsinë e sanksioneve në media të ndryshme.*

- Çfarë barrierash për hyrje krijon sistemi rregullator dhe institucional për hyrësit e rinj në tregun e medias (p.sh. tarifa themelimi apo kufizime të tjera)?

*Për mediat audiovizive ligji parashikon pagesë për marrjen e licencës dhe/ose autorizimit, që është e ndryshme nga pagesa vjetore për licencën dhe/ose autorizimin. Për mediat e tjera jo-audiovizive nuk ka kufizime të kësaj natyre.*

- A luan rol përqendrimi i medias në procesin e ndarjes së spektrit?

*Menaxhimi i spektrit të frekuencave bëhet nga AMA. Caktimi i frekuencave bëhet mbi bazën*

*e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t'u administruar nga AMA. Përqendrimi i medias nuk luan rol në menaxhimin e spektrit të frekuencave tokësore.*

- A është procesi vendimmarrës mbi ndarjen e frekuencave mes transmetuesve publikë, privatë dhe komunitarë transparent, i hapur, pjesëmarrës dhe i mbikëqyrur nga një autoritet i pavarur rregullator, i cili plotëson standardet ndërkombëtare dhe është i lirë nga ndërhyrjet politike apo komerciale apo nga interesa të fshehura?

*Procesi i shpërndarjes së frekuencave është i hapur. Ndarja e frekuencave mes transmetuesit publik dhe atyre privatë është e rregulluar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Procesi zhvillohet nga AMA, një organ i pavarur. Përsa i përket ndërhyrjeve politike apo tregtare, ekzistojnë kritika dhe ankesa nga operatorë të ndryshëm.*

- A shpërndahet reklama e shtetit në media në media në mënyrë të ndershme, për shembull, në përpjesëtim me shikueshmërinë? Si mund t'i përshkruani rregullat e shpërndarjes së reklamave shtetërore? A po monitorohet ajo?

*Reklamat shtetërore nuk shpërndahen në mënyrë të ndershme midis mediave. Nuk ekziston një mekanizëm që të detyrojë shpërndarjen në bazë të shikueshmërisë. Rregullat e prokurimit të reklamave shtetërore janë tepër të thjeshtuara dhe lënë shumë vend për abuzim, sidomos me lejimin e pjesëmarrjes së agjencive publicitare në garë, të cilat më pas mund t'i shpërndajnë reklamat pa qenë të detyruara të respektojnë asnjë kriter të përcaktuar. Nuk ka një organ të mandatuar për monitorimin e këtij procesi. Një tjetër problem lidhet me reklama që përfshihen indirekt në projekte të organeve të pushtetit ekzekutiv apo pushtetit vendor, që nuk i nënshtrohen asnjë rregulli prokurimi.*

*Gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore 2023 u raportuan shkelje në shpërndarjen e reklamave shtetërore. Kodi Zgjedhor i ndalon institucionet publike të reklamojnë katër muaj para zgjedhjeve, por reklamat e disa autoriteteve publike janë gjetur në shumë media online, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pretendoi se nuk mund të vepronte për shkak të ligjit të paqartë që "ndalon vetëm reklamat në radio dhe televizion"*

- A ka një monitorim të shpërndarjes së reklamave?

*Monitorimi i shpërndarjes së reklamave kryhet nga AMA. Ligji nuk lejon që një subjekt të zotërojë më shumë se 30% të tregut të reklamave në vend. Sipas strukturës organizative*



të AMA-s, konstatohet se ky autoritet ka ngritur një sektor që merret me këtë monitorim. Megjithatë, nuk është e qartë se sa efikas mund të jetë ky monitorim, duke qenë se sasia e reklamave matet me kohë transmetimi dhe jo me vlerë e reklamave në treg.

- A ka ligje apo politika të tjera përmes të cilave qeveria ndërhyr në biznesin e medias (p.sh. bllokimi i faqeve të internetit apo censurë)? Cilat? A është liria e shtypit dhe pavarësia editoriale e garantuar në ligj dhe a respektohet ajo në praktikë? (Ju lutem shpjegoni shkurtimisht)

Aktualisht nuk ekziston ndonjë akt ligjor që i jep të drejtën organeve të qeverisjes për të ndërhyrë në biznesin e medias. Liria e shtypit është e garantuar nga ligji, në parim. Në praktikë, ka raste ankesash nga media dhe shoqatat e gazetarëve që pretendojnë për ndërhyrje në lirinë e shtypit. Vetëcensura është shpesh edhe pasojë e lidhjeve të ngushta midis pronarëve të kompanive mediatike dhe kompanive aktive në fusha të tjera (p.sh. në sektorin e ndërtimit) që konkurrojnë për fonde shtetërore – në fakt, ndonjëherë pronarët e të dy llojeve të kompanive janë të njëjtë .

- A ka pasur ndryshime madhore në këto tema (reklama shtetërore, procesi i alokimit të spektrit, taksat për mediat) përgjatë pesë viteve të fundit? A ka pasur raste konfliktesh apo padi për këto tema?

Nuk ka pasur asnjë ndryshim në rregullat e prokurimit shtetëror për reklamat. Nga qeveria miratohen rregullisht politika të reja fiskale, megjithatë këto politika kanë qenë të natyrës së përgjithshme, janë të zbatueshme për të gjitha llojet e bizneseve dhe nuk janë specifike për kompanitë mediatike.

## **I.5. Neutraliteti i rrjetit dhe diversiteti i medias**

### a. Kuadri Ligjor

- Cilat ligje ose rregulla të tjera përdoren për të rregulluar neutralitetin e rrjetit, nëse ka?

Neutraliteti i rrjetit parashikohet me ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas këtij ligji, “Qëllimi i këtij ligji është që, nëpërmjet parimit të neutralitetit teknologjik, të nxisë konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbime të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

I njëjti parim parashikohet në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

- Cili është statusi juridik i normave përkatëse? (ligji kushtetues, statutet, vendimet rregullatore, urdhëresat vendore, etj.)

*Kushtetuta nuk përmban ndonjë dispozitë specifike për neutralitetin e rrjetit. Ajo parashikon vetëm ndalimin kushtetues të censurës së mëparshme, e cila mund të shihet si pasojë e një rrjeti jo neutral. Rregullorja aktuale është me ligj, e miratuar nga Parlamenti.*

- Si e përcakton ligji neutralitetin e rrjetit?

*Ligji përmend vetëm parimin e “neutralitetit teknologjik” ose “paanshmërisë teknologjike”. Përshkrimi është lakonik dhe nuk ka zhvillim të mëtejshëm të konceptit, me përjashtim të disa dispozitave që kanë të bëjnë me tarifën sa më afër kostos dhe barazinë e tarifave, koncepte që lidhen me adoptimin e parimit të neutralitetit të rrjetit.*

- Nëse nuk ka në fuqi ligje t që adresojnë neutralitetin e rrjetit, a propozohen ligje për ta bërë këtë?

*Aktualisht nuk ka asnjë nismë legislative në pritje ose në shqyrtim për futjen e rregulloreve të mëtejshme mbi neutralitetin e rrjetit.*

- A janë propozuar më parë ligje për adresimin e neutralitetit të rrjetit?

*Me përjashtim të ligjit nr. 9918/2008, ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, ligjin nr. 107/2018 dhe ligjin nr. 92/2019, nuk ka pasur asnjë nismë tjetër politike apo legislative për të futur ndonjë rregullore për neutralitetin e rrjetit.*

- A po diskutojnë ligjvënësit për neutralitetin e rrjetit?

*Aktualisht nuk ka asnjë nismë politike për të futur rregullore të mëtejshme mbi neutralitetin e rrjetit.*

a. Zbatimi

- Si rregullohet neutraliteti i rrjetit?

*Neutraliteti i rrjetit rregullohet vetëm në parim me ligjin nr. 9918/2008, por mungojnë rregullore specifike.*

- Cilat agjenci apo autoritete rregullatore janë të ngarkuara për zbatimin e normave të neutralitetit të rrjetit?

*Sipas Nenit 6 të ligjit nr. 9918/2008, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar në këtë ligj, ligjin e shërbimit postar dhe politikat*

*e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.*

*Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është anëtar i BEREC, Organi i Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike.*

- Cili është/janë mekanizmi/at e zbatimit? (vendosja e sanksioneve, marrëveshjet vullnetare, etj.)

*Ligji përmban sanksione që zbatohen nga AKEP-i, si dhe përmban dispozita për marrëveshjet ndërmjet operatorëve, por ato nuk lidhen drejtpërdrejt me neutralitetin e rrjetit.*

- Nëse ekzistojnë mekanizma përmbarues, a janë ata efektivë?

*Meqenëse nuk ka dispozita konkrete në ligj, është e pamundur të merret në konsideratë ndonjë zbatim efektiv.*

- Cilët mekanizma zbatues kanë qenë efektivë dhe cilët kanë qenë joefektivë?

*Duke qenë se nuk ka dispozita konkrete në ligj, është e pamundur të bëhet dallimi midis zbatimit efektiv dhe atij joefektiv.*

- Për cilat subjekte zbatohen normat e neutralitetit të rrjetit? / Cili është qëllimi i rregullimit të neutralitetit të rrjetit? (broadband, celular, etj.)

*Ligji zbatohet për të gjitha subjektet, rrjetet fikse, broadband, celulare etj. Neutraliteti i rrjetit përshkruhet si një parim i ligjit dhe si rregull duhet të zbatohet njësoj për të gjithë subjektet e tij.*

- Çfarë përjashtimesh ekzistojnë për zbatimin e normave të neutralitetit të rrjetit? (menaxhimi i trafikut, siguria, ligjshmëria e përmbajtjes, etj.)

*Ligji nuk përmend kufizime konkrete në zbatimin e parimit të neutralitetit të rrjetit.*

*Megjithatë, Neni 15 i ligjit nr. 9918/2008, në pikën 1/e parashikon si detyrim për dhënien e autorizimit edhe respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregulloreve ligjore përkatëse në fuqi. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) nuk ka kompetenca për të rishikuar përmbajtjen, por zbaton urdhrat e organeve kompetente (p.sh. gjykatat). Një dispozitë e tillë është përpunuar në rregulloren nr.47, datë 26.10.2017, "Për zbatimin e autorizimit të përgjithshëm", në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, që përcakton:*

*"Kufizimet zbatohen për transmetimet e përcaktuara se përmbajnë përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme në bazë të një vendimi të marrë nga organet kompetente të parashikuara në legjislacionin përkatës. Sipërmarrësi/subjekti që ofron rrjetin dhe/ose shërbimin/et e*

*komunikimeve elektronike ka detyrimin ligjor të marrë masat e duhura ligjore dhe teknike për zbatimin e kufizimit të kërkuar. AKEP, me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit të përmbajtjes së paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësit, subjektit që ofron rrjetin dhe /ose shërbime publike të komunikimit elektronik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtjeje.”*

## Pjesa II. Treguesit - Lista e plotë

### II.1. Masat mbrojtëse rregullore kundër përqendrimit të lartë të pronësisë dhe /ose kontrollit (horizontal) në media

TELEVIZION	Përshkrimi	Po	Jo	N A	M D	
A përmban <b>legjislacioni i mediave pragje ose kufizime specifike</b> , bazuar në kritere objektive (p.sh. numri i licencave, pjesëmarrja e publikut, qarkullimi, shpërndarja e kapitalit të aksioneve ose të drejtës së votës, qarkullimi/të ardhurat) për të parandaluar një nivel të lartë të <b>përqendrimit horizontal</b> të pronësisë dhe/ose kontroll në këtë sektor?	Kjo pyetje synon të vlerësojë ekzistencën e masave mbrojtëse rregullore (sektoriale) kundrejt përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe / ose kontrollit në sektorin e TELEVISIONIT	0.5				Ekzistenca e masave mbrojtëse
A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me kufijtë në sektorin audioviziv dhe/ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i medias dhe/ose autoriteti i konkurrencës)?	Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji / rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.	1				
A garanton ligji sistem sanksionesh/zbatueshmëri, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe /ose strukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve të vendosura?	Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit ose blerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	1				

A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese/zbatuese?	Ky tregues synon të vlerësojë zbatimin efektiv të mjeteve juridike specifike sektoriale ndaj përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe/ ose kontrollit në mediat televizive.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në Mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale		0.5	Implementimi Efektiv (I)
<b>Totali</b>		3			

SHTYPI	Përshkrimi	Po	Jo	N A	M D	
A përmban <b>legjislacioni i mediave pragje ose kufizime specifike</b> , bazuar në kritere objektive (p.sh. numri i licencave, pjesëmarrja e publikut, qarkullimi, shpërndarja e kapitalit të aksioneve ose të drejtës së votës, qarkullimi / të ardhurat) për të parandaluar një nivel të lartë të <b>përqendrimit horizontal</b> të pronësisë dhe / ose kontroll në këtë sektor?	Kjo pyetje synon të vlerësojë ekzistencën e masave mbrojtëse rregullatore (sektoriale) kundrejt përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe / ose kontrollit në sektorin e SHTYPIT	0				Ekzistenca e masave mbrojtëse
A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me pragjet në sektorin audioviziv dhe / ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i medias dhe/ose autoriteti i konkurrencës)?	Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji / rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.	0				
A garanton ligji sistem sanksionesh/fuqizim në zbatim, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe/ose strukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve të vendosura?	Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit ose blerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	0				



A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese/ zbatuese?	Ky tregues synon të vlerësojë zbatimin efektiv të mjeteve juridike specifike sektoriale ndaj përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe/ ose kontrollit në mediat televizive.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale	X		Implementimi efektiv (I)
<b>Totali</b>		0			

RADIOJA	Përshkrimi	Po	Jo	N A	M D		
<p>A përmban <b>legjislacioni i mediave pragje ose kufizime specifike</b>, bazuar në kritere objektive (p.sh. numri i licencave, pjesëmarrja e publikut, qarkullimi, shpërndarja e kapitalit të aksioneve ose të drejtës së votës, qarkullimi / të ardhurat) për të parandaluar një nivel të lartë të <b>përqendrimit horizontal</b> të pronësisë dhe / ose kontroll në këtë sektor?</p>	<p>Kjo pyetje synon të vlerësojë ekzistencën e masave mbrojtëse rregullatore (sektoriale) kundrejt përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe / ose kontrollit në sektorin e RADIOS?</p>	0.5				Ekzistenca e masave mbrojtëse	
<p>A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me pragjet në sektorin audioviziv dhe / ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i medias dhe/ose autoriteti i konkurrencës)? A garanton ligji sistem sanksionesh/fuqizim në zbatim, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe /ose strukturore) në rast të mosrespektimit tëpragjeve të vendosura?</p>	<p>Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji / rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.</p>	1					
	<p>Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit oseblerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	1					

A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese/zbatuese?	Ky tregues synon të vlerësojë zbatimin efektiv të mjeteve juridike specifike sektoriale ndaj përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe/ ose kontrollit në mediat televizive.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale		0.5	Implementimi Efektiv (I)
<b>Totali</b>		3			

INTERNETI	Përshkrimi	Po	Jo	N A	M D	
A përmban <b>legjislacioni i mediave pragje ose kufizime specifike</b> , bazuar në kritere objektive (p.sh. numri i licencave, pjesëmarrja e publikut, qarkullimi, shpërndarja e kapitalit të aksioneve ose të drejtës së votës, qarkullimi/të ardhurat) për të parandaluar një nivel të lartë të <b>përqendrimit horizontal</b> të pronësisë dhe/ose kontroll në këtë sektor?	Kjo pyetje synon të vlerësojë ekzistencën e masave mbrojtëse rregullatore (sektoriale) kundrejt përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe / ose kontrollit në sektorin e INTERNETIT.	0				Ekzistenca e masave mbrojtëse
A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me pragjet në sektorin audioviziv dhe / ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i medias dhe/ose autoriteti i konkurrencës)?	Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji/rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.	0				
A garanton ligji sistem sanksionesh/fuqizim në zbatim, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe/ose strukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve të vendosura?	Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit ose blerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	0				

A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese / zbatuese?	Ky tregues synon të vlerësojë zbatimin efektiv të mjeteve juridike specifike sektoriale ndaj përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe/ ose kontrollit në mediat televizive.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale	X		Implementimi Efektiv
<b>Totali</b>		0			

BASHKIMI I MEDIAVE	Përshkrimi	Po	Jo	N A	M D	
<p>A mund të pengohet përqendrimi horizontal në nivel të lartë të pronësisë dhe ose kontrolli në sektorin e medias nëpërmjet rregullave të kontrollit të bashkimit / konkurrencës që marrin parasysh specifikat e sektorit të medias?</p>	<p>Kjo pyetje ka për qëllim të vlerësojë ekzistencën e rregullave për masa mbrojtëse (ligji specifik isektorit dhe / ose të konkurrencës) kundër një përqendrimi të lartë horizontal të pronësisë dhe/ose kontrollit në sektorin e medias përmes bashkimit të veprimtarive. Për shembull, ligji duhet të parandalojë përqendrimin në bashkimin e operacioneve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mes dispozitave specifike për mediat që imponojnë pragje më të rrepta se sa në sektorët e tjerë;</li> <li>- Ndërhyrje të detyrueshme të autoritetit të medias në rastet e shkrirjes dhe blerjes (për shembull, detyrimi i autoritetit të konkurrencës të kërkuar këshillën e autoritetit të medias);</li> <li>- Mundësia për të anuluar miratimin e një përqendrimi nga autoriteti i komunikimit për arsye të pluralizmit të medias (ose interesit publik në përgjithësi); - pasi - edhe pse ato nuk përmbajnë dispozita specifike për media - nuk përjashtojnë sektorin e medias nga fushëveprimi i tyre.</li> </ul>	0.5				e Ekzistenca
<p>A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me rregullat për bashkimin dhe / ose dëgjimin e ankesave? (p.sh. autoriteti i medias dhe/ose autoriteti i konkurrencës)?</p>	<p>Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji/rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.</p>	0.5				



A garanton ligji sanksione/fuqizim të zbatimit të tij, me qëllim përdorimin e mjeteve juridike proporcionale (sjellje dhe/osestrukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve?	Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit ose blerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	0.5				
A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese/zbatuese?	Ky tregues synon të vlerësojë zbatimin efektiv të mjeteve juridike specifike sektoriale ndaj përqendrimit të lartë horizontal të pronësisë dhe/ose kontrollit në mediat televizive.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale. <b>Rrezik i lartë:</b> autoriteti përkatës nuk i përdor kurrë kompetencat e tij sanksionuese	0		Implementimi Efektiv	
<b>Totali</b>		1.5				

## II.2. Kuadri Rregullator për Mediat dhe Rregullorja e Neutralitetit të Rrjetit

NEUTRALITETI I RRJETIT	Përshkrim	Po	Jo	NA	MD
A e trajton ligji kombëtar neutralitetin e rrjetit drejtpërdrejt apo tërthorazi?	Kjo pyetje synon të përcaktojë nëse neutraliteti i rrjetit rregullohet nga ligji vendas në ndonjë mënyrë; synon gjithashtu të pasqyrojë çdo marrëveshje midis vendeve, si në BE dhe vendeve që janë pjesë e Këshillit të Evropës.	0.5			
A përmban ligji kombëtar rregulla që ndalojnë bllokimin e faqeve të internetit ose përmbajtjes në internet?	Kjo pyetje përcakton shkallën në të cilën normat e neutralitetit të rrjetit të një vendi parandalojnë bllokimin, një nga komponentët kryesorë të një kuadri të fortë neutraliteti rrjeti.	0			
A përmban ligji kombëtar rregulla që ndalojnë kufizimin e shpejtësisë së lidhjes në internet apo përmbajtje të ofruar në internet?	Kjo pyetje përcakton shkallën në të cilën normat e neutralitetit të rrjetit të një vendi parandalojnë kufizimin e shpejtësisë së lidhjes në internet, një nga komponentët kryesorë të një kuadri të fortë neutraliteti rrjeti.	0			
A përmban ligji rregulla që ndaloje praktikën e 'zero' rating ose priorizim të një kompanie sipas pagesës?	Kjo pyetje përcakton shkallën në të cilën normat e neutralitetit në rrjet të një vendi parandalojnë 'zero rating' (nga i cili priorizimi me pagesë është një formë e zakonshme), një nga komponentët kryesorë të një kuadri të fortë neutraliteti rrjeti.	0			
Aty ku neutraliteti i rrjetit mbrohet me ligj, a nje kuadri ligjor ndonjë përjashtim, p.sh. për menaxhim të arsyeshëm të rrjetit?	Kjo pyetje përcakton kur vendosen kufij të arsyeshëm për mbrojtjen e neutralitetit të rrjetit kundrejt kufijve të tjerë që mund të dëmtojnë efektivitetin e tij.	0			

A bëhet prioritizimi me pagesë pavarësisht normave që ndalojnë ose kufizojnë 'zero rating'?	Kjo pyetje synon të nxjerrë në pah shkallën në të cilën "prioritizimi me pagesë" ndodh në praktikë, pavarësisht nga ndalimi i tij në ligj; një numër vendesh me mbrojtje gjoja të forta kundër 'zero rating' e përjetojnë këtë fenomen. Ky tregues mund të hedhë dritë mbi shkallën e dallimit midis ligjit dhe praktikave në terren.	0			
A zhvillohen forma të tjera të 'zero rating' pavarësisht kufizimeve të përmendura?	Njësoj si më sipër.	0			
A ndodhin bllokimi dhe/ose kufizimi i shpejtësisë së lidhjes së internetit, pavarësisht ekzistencës së rregullave që ndalojnë praktika të tilla?	Kjo pyetje kërkon të përcaktojë se si funksionon në praktikë kuadri ligjor në fuqi për të mbrojtur neutralitetin e rrjetit në lidhje me bllokimin dhe kufizimin e shpejtësisë së lidhjes së internetit.	0.5			
A ka subjekte rregullatore ose të tjera të ngarkuara me monitorimin dhe zbatimin e mbrojtjes së neutralitetit të rrjetit?	Kjo pyetje nxjerr në pah nëse ka autoritete të ngarkuara me zbatimin e mbrojtjes së neutralitetit të rrjetit.	0			
A janë vendosur sanksione për shkelje të mbrojtjes së neutralitetit të rrjetit aty ku këto ekzistojnë?	Kjo pyetje mund të ilustrojë shkallën në të cilën shkeljet e normave të neutralitetit të rrjetit merren seriozisht si çështje e sundimit të ligjit dhe vullneti politik.	0			
A konsiderohen si efektive mekanizmat e zbatimit për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur shkeljeve të neutralitetit të rrjetit?	Kjo pyetje tregon shkallën në të cilën rregullat e neutralitetit të rrjetit i arrijnë në të vërtetë qëllimet e tyre.	0			
<b>Totali</b>		1.0			

### II.3. Masat mbrojtëse rregullatore kundër shkallës së lartë të ndër-pronësisë

NDËR-PRONËSIA E MEDIATEVE	Përshkrimi	Yes	No	N A	M D
A përmban <b>legjislacioni i mediave pragje ose kufizime specifike</b> , bazuar në kritere objektive të tilla si numri i licencave, pjesëmarrja e publikut, qarkullimi, shpërndarja e kapitalit të aksioneve ose të drejtës së votës, qarkullimi / të ardhurat, për të parandaluar një nivel të lartë të ndër-pronësisë mes mediave të ndryshme?	Kjo pyetje synon të vlerësojë ekzistencën e masave mbrojtëse rregullatore (sektoriale) kundrejt nivelit të lartë të pronësisë së kryqëzuar (ndër-pronësisë) në sektorë të ndryshëm të medias	0			
A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron në mënyrë aktive pajtueshmërinë me pragjet në sektorin audioviziv dhe /ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i mediave)? A garanton ligji sistem sanksionesh/fuqizim në zbatim, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe/ose strukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve të vendosura?	Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji/rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me përqendrimin e mediave audiovizive.	0			
	Variabli synon të vlerësojë nëse ligji siguron sistem të duhur sanksionesh për rregullimin e sektorit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i licencave shtesë;</li> <li>• Bllokimi i bashkimit ose blerjes;</li> <li>• Detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta;</li> <li>• Detyrimi për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias.</li> <li>• Privime</li> </ul>	0			

<p>A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese/zbatuese?</p>	<p>Autoritetet përkatëse nuk përdorin asnjëherë kompetencate tyre sanksionuese. Ky tregues ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të mjeteve juridike të parashikuara nga rregullorja.</p>	<p><b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale. <b>Rrezik i lartë:</b> autoriteti përkatës nuk i përdor kurrë kompetencat e tij sanksionuese.</p>		
<p>A mund të pengohet një shkallë e lartë e ndër-pronësisë ndërmjet mediave të ndryshme, nëpërmjet rregullave të kontrollit të bashkimit / konkurrencës që marrin parasysh specifikat e sektorit të medias?</p>	<p>Për shembull, ndër-pronësia mund të parandalohet me ligjin e konkurrencës: - nga ndërhyrja e detyrueshme e një autoriteti të medias në rastet e M &amp; A (për shembull, detyrimi i autoritetit të konkurrencës për të kërkuar këshillën e autoritetit të medias); - nga mundësia për të anuluar miratimin e një përqendrimi nga autoriteti i konkurrencës për arsye të pluralizmit të medias (ose interesit publik në përgjithësi); Edhe pse ligji nuk përmban dispozita specifike për mediat -nuk përjashton sektorin e medias nga fushëveprimi i tij.</p>	<p>0</p>		

A ekziston një autoritet administrativ ose organ gjyqësor që monitoron pajtueshmërinë me këto rregulla dhe / ose dëgjon ankesat? (p.sh. autoriteti i mediave dhe/ose autoriteti i konkurrencës)?	Ky variabël synon të vlerësojë nëse ligji / rregullorja siguron një sistem të duhur monitorimi dhe sanksionesh për rregullimin lidhur me nivelin e lartë të ndërpronësisë së sektorëve të ndryshëm në media përmes rregullave të kontrollit/konkurrencës së përqendrimit.	0		
A garanton ligji sistem sanksionesh/fuqizim në zbatim, me qëllim të përdorimit të mjeteve proporcionale (sjelljeje dhe /ose strukturore) në rast të mosrespektimit të pragjeve të vendosura?	Shembuj të fuqisë sanksionuese/ zbatuese dhe mjeteve juridike: - bllokimin e bashkimit ose blerjes; - detyrimi për ndarjen e dritareve për programimin e palëve të treta; - kryerjen e obligimit për të hequr licencat / aktivitetet në sektorë të tjerë të medias; - Privime	0		
A përdoren në mënyrë efektive kompetencat sanksionuese / zbatuese?	Ky tregues ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të mjeteve juridike të parashikuara nga rregullorja.	<b>Rrezik i ulët:</b> autoriteti ushtron në mënyrë efektive kompetencat e tij sanksionuese në të gjitha rastet eventuale <b>Rrezik i mesëm:</b> kompetencat e autoritetit nuk ushtrohen gjithmonë në të gjitha çështjet eventuale.		
<b>Total (Mesatarja e nën-indikatorëve L-e und L-I)</b>		0		

## II.4. Masat mbrojtëse rregullatore për transparencën e pronësisë dhe/ose kontrollit

Dispozita mbi transparencën	Përshkrimi	Po +	Jo -	NA	MD	
A përmbajnë ligjet kombëtare (mbi median, shoqëritë tregtare, taksat...) <b>dispozita mbi transparencën dhe informimin</b> , që të detyrojnë publikimin nga kompanitë mediatike të strukturave të tyre të pronësisë në faqen e tyre të internetit ose në regjistra/ dokumente, <b>të aksesueshme për publikun?</b>	Qëllimi i kësaj pyetjeje është kontrolli i masave mbrojtëse lidhur me transparencën, nëpërmjet qytetarëve, përdoruesve dhe publikut në përgjithësi.	0				Ekzistenca (E)
A përmbajnë ligjet kombëtare (mbi median, shoqëritë tregtare, taksat ...) <b>dispozita mbi transparencën dhe informimin</b> , që të detyrojnë publikimin nga kompanitë mediatike <b>të ndryshimeve në strukturën e pronësisë tek autoritetet publike</b> (si autoriteti i medias)	Qëllimi i kësaj pyetjeje është kontrolli i masave mbrojtëse lidhur me transparencën dhe llogaridhënien nëpërmjet autoriteteve publike.	1				
A ka ndonjë detyrim sipas legjislacionit kombëtar që <b>të bëj publike</b> informacionin përkatës pas <b>çdo ndryshimi</b> në strukturën e pronësisë?	Kjo pyetje ka për qëllim vlerësimin nëse ligji ofron rregulla për disponueshmërinë e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi pronësinë e medias. Ky është një kusht për një transparencë efektive.	1				
A ka ndonjë <b>sanksion</b> në rast të mosrespektimit të detyrimeve të publikimit?	Kjo pyetje synon të vlerësojë nëse ligji për transparencën e pronësisë së medias mund të zbatohet përmes zbatimit të sanksioneve.	1				Implementimi efektiv (I)

<p>A garantojnë detyrimet ligjore informimin e publikut se cili person juridik ose fizik në mënyrë efektive zotëron ose kontrollon kompaninë mediatike?</p>	<p>Kjo pyetje ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të ligjeve që kanë të bëjnë me transparencën e pronësisë së medias dhe nëse ato arrijnë të zbulojnë pronarët e vërtetë të mediave.</p>	<p><b>Rrezik i ulët:</b> Të gjithë pronarët efektivë njihen nga publiku. <b>Rrezik mesatar:</b> disa pronarë janë ende të panjohur. <b>Rrezik i lartë:</b> Pronarët efektivë janë ende të fshehur.</p>	0.5		
<p><b>Totali (Mesatarja e nën-indikatorëve L-e dhe L-I)</b></p>		3.6			



## II.5. Masat mbrojtëse rregullatore kundër kontrollit politik mbi pronësinë e mediave dhe rrjeteve të shpërndarjes

Pronësia nga politikanët	Po +	Jo -	NA	MD
A ka ndonjë ligj që përmban <b>kufizime</b> për <b>pronësinë</b> dhe kontrollin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të mediave kryesore <b>nga politikanët</b> ?	0.5			
A zbatohet <b>rregullorja</b> për <b>të gjitha mediat</b> (të shtypit, audiovizuale dhe online) pa përjashtime të rëndësishme?	1			
A ekziston një <b>organ</b> administrativ ose gjyqësor që <b>monitoron pajtueshmërinë</b> me këto rregulla dhe/ose dëgjon ankesat?	1			
A garanton ligji organe efektive për <b>sanksionimin/zbatimin</b> me qëllim të vendosjes së mjeteve juridike proporcionale në rast të mospërputhjes me rregullat?	1			
<b>Totali</b>	3.5			

## II.6. Kuadri Ligjor për Rregullimin e Medias

Ju lutemi, raportoni mbi autoritetet përkatëse përgjegjëse për monitorimin e përqendrimit të medias në vendin tuaj. Ky mund të jetë:


- Autoriteti i Medias
- Autoriteti i Konkurrencës
- Autoriteti i Telekomunikacionit

Nëse ka autoritete të ndryshme, ju lutem, kopjoni listën e kontrollit dhe plotësoni një listë të plotë për çdo autoritet.

(Specifikoni autoritetin dhe vendosni emrin) Autoriteti i Mediave, Autoriteti i Konkurrencës	Po +	Jo -	NA	MD
A ka <b>garanci</b> kushtetuese apo ligjore në mënyrë eksplicite për <b>pavarësinë e autoritetit të medias</b> nga ndërhyrja politike apo tregtare?	1			

A janë <b>procedurat e emërimit</b> për autoritetin e medias <b>transparente, demokratike dhe objektive</b> dhe a janë ato të dizajnuara për të minimizuar rrezikun e ndërhyrjes politike apo tregtare, për shembull duke përfshirë rregullat mbi pajtueshmërinë dhe përshtatshmërinë?	1			
A janë transparente dhe objektive <b>procedurat për ndarjen e burimeve buxhetore</b> për autoritetin e medias, pra, që nuk lënë vend për vendime arbitrare nga pushtetet qeverisëse?	1			
A janë <b>detyrat, përgjegjësitë</b> e autoritetit të medias të përcaktuara në detaje në ligj (p.sh. licencat e granteve, monitorimi i pajtueshmërisë, sanksionimi, të tjera)?	1			
A i atribuon ligji <b>të drejtën e dhënies së sanksioneve</b> , autoritetit të medias (p.sh paralajmërimi, gjoba, pezullimi ose revokimi i licencës, të tjera)?	1			
Sa i përket vendimeve të autoritetit të medias, a ekzistojnë <b>mekanizma efektiv të ankesave</b> ?	1			
<b>A respektohen</b> në praktikë, procedurat e emërimit për autoritetin e medias <b>në praktikë</b> ?	0			
A tregon <b>praktika vendimmarrëse e autoritetit të medias</b> , se autoriteti i përdor kompetencat e tij në praktikë në interes të publikut?	0.5			
A është <b>i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm buxheti</b> i autoritetit të medias për të ruajtur pavarësinë e tij dhe /ose për ta mbrojtur atë nga presionet financiare detyruese dhe për të kryer funksionet e veta?	1			
Qeveria nuk mund të <b>anashkalojë arbitrarisht vendimin e autoritetit të medias</b> .	1			
A është autoriteti i medias <b>përgjegjës para publikut për aktivitetet e tij</b> (p.sh. kërkohet që të publikojë raporte të rregullta ose ad hoc lidhur me punën e tij apo ushtrimin e misionit të tij)?	1			
<b>Totali</b>	9.5			





# Vlerësimi i kuadrit ligjor

MONITORIMI I PRONËSISË SË MEDIAS, **SHQIPËRI**